

VENDIM
Nr. 284, datë 7.11.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 150, DATË 10.6.2022, “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘DANSKE COMMODITIES ALBANIA’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885 prot, datë 1.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s n. 150, datë 10.6.2022, ‘Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Danske Commodities Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe qëndrimin e Këshilltares së Bordit,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 150, datë 10.6.2022, ka vendosur:
- Të rinovojë licencën e shoqërisë “*Danske Commodities Albania*” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 4.7.2022.
- Shoqëria “*Danske Commodities Albania*” sh.p.k., në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE, vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.
- Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të vendimmarrjes së organit tatimor në përfundim të procesit të vlerësimit mbi procesin e apelimit të nisur nga shoqëria “*Danske Commodities Albania*” sh.p.k., që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimmarrjeje.
- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 477/4 prot., datë 17.6.2022.
- Me dokumentacionin e depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 477/5 prot., datë 17.10.2022, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 150/2022.
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 150, datë 10.6.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “*Danske Commodities Albania*” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti